



## Problemet e librit të Jobit

### Description

#### Rezart Beka

Problemi i parë që lind gjatë hulumtimit të këtij libri ka të bëjë me autorësinë dhe kohën e daljes në dritë të këtij botimi.

Gjatë studimeve të hollësishme të studiuesve të krishterë në përpjekje për të identifikuar autorin e kësaj vepre, asnjë argument i vlefshëm që do të mund të ndihmonte për njohjen e tij nuk është gjetur. Nisur nga ky fakt, studiuesit janë në një mendje se autori i kësaj vepre është i panjohur.

Në një nga përkthimet e mirënjohura të Biblës në gjuhën italiane thuhet: “*Nuk dihet me siguri se cili është autori i kësaj vepre...*” [1]

“New Bible Dictionary” pohon: “*Autori i librit është i panjohur*” [2]

Libri paraqitet problematik edhe për datën e hartimit të tij.

Profesori i Universitetit Erlangen – Nürnberg, Georg Fohrer, shprehet se “*data e hartimit të librit nuk mund të përcaktohet me siguri*” [3].

Duncan B. Macdonald, profesor i gjuhëve semite në Hartford Theological Seminary, thotë: “*Është e qartë se data nuk mund të saktësohet. Elementë të ndarë mund të janë të përhapur kudo nga fundi i shekullit të 7-të deri në shekullin e 4-t p.e.s.*” [4].

Siç shihet, libri i Jobit është vepër e një njeriu të panjohur, mbi jetën dhe besueshmërinë e të cilit nuk dihet asgjë. Ai vetë nuk ka jetuar në kohën e ngjarjeve për të cilat bën fjalë dhe për shkak të pamundësisë së identifikimit të tij, nuk është e arsyeshme të pretendohet se ai ka shkruar i frymëzuar nga Zoti. Edhe vetë teksti nuk lejon nxjerrjen e një përfundimi të tillë, pasi në asnjë rresht të tij nuk pohohet të jetë shkruar nën ndikimin e ndonjë frymëzimi hyjnor. Të gjitha këto hollësi e ulin ndjeshëm besueshmërinë e kësaj vepre.

Problemi i dytë në hulumtimin e këtij libri ka të bëjë me shtesat, ndryshimet dhe përpunimet që ka

pësuar teksti i tij nga koha e hartimit deri në ditët tona.

A gëzon ky libër një unitet të brendshëm, një vijë logjike të pandërprerë apo është fryt i shumë autorëve të panjohur të cilët kanë shtuar, hequr, rishikuar pjesë të ndryshme të këtij libri?

A ka ardhur ky libër deri në ditët tona ashtu siç është shkruar nga autori fillestar apo me kalimin e shekujve njerëz të ndryshëm kanë vënë dorë mbi të duke shtuar, hequr, rishikuar apo përpunuar pjesë të tëra nga teksti i tij?

E vërteta është se ky libër nuk gëzon unitet të brendshëm. Vija logjike brenda tekstit ndërpritet nga pjesë të caktuara që duken qartë se janë shtesa që janë përfshirë më pas në tekst.

Studiuesi Davide Levi shprehet kështu në lidhje me unitetin e brendshëm të librit të Jobit: *“Redaktuar në shekullin e V, me ndërhyrje të mëvonshme deri në shekullin e III.”* [5].

Prof. Duncan B. Macdonald, në përfundim të temës së titulluar “Problemet e librit”, sjell një shembull për ta bërë sa më të lehtë gjendjen, në të cilën ky tekst ka ardhur deri në ditët tona: *“Në përfundim, nëse përfytyrojmë që Gëte të kishte vdekur përpara se të mbaronte “Faustin” e tij, duke lënë pjesën e parë të botuar, të dytën të parregulluar, me pasazhet paralele të pafshira dhe zgjidhjen letrare të pashkruar e më pas ndonjë redaktor mekanik ta kishte marrë atë të tërën, ta kishte lidhur e bashkuar dhe ta kishte mbyllur me fundin e “Volksbuch” të “Faustit”, do të kemi një paralel të trashë të jashtëm për të paraqitur gjendjen e Librit të Jobit... Duket se është e sigurtë që disa autorë kanë punuar në problemin e rrjedhës së ngjarjeve.”* [6].

Problemi i tretë ka të bëjë me historicitetin e këtij libri. A është libri i Jobit një histori e vërtetë apo e shpikur nga autori i panjohur për qëllime të ndryshme teologjike?

Carlo Ghidelli, duke bërë fjalë për këtë libër nën temën e titulluar *“Histori apo shpikje”*, na tërheq vëmendjen me këto fjalë: *“Nuk duhet të biem në grackë...Jobi nuk është një personazh historik. Historia e tij është e shpikur...Ashtu siç ka bërë Jezusi me shëmbëlltyrat, kështu edhe autori i këtij libri ka shpikur një ngjarje për ta bërë më të kuptueshëm mësimin fetar”* [7].

Pra, libri i Jobit është një trill letrar i krijuar për qëllime teologjike. Ajo që duhet thënë është se autori i librit nuk e paraqet aspak këtë libër si një histori të shpikur. Përkundrazi, çdo lexues i tij e ka të qartë se autori pretendon ta paraqesë historinë e Jobit si të vërtetë. Vetëm duke pasur parasysh këtë, mund të kuptojmë rëndësinë e problemit që ngre Carlo Ghidelli.

Problemi i katërt: Burimet pagane

Mitologjitë e Orientit e paraqisnin veprën e krijimit si një triumf të një zoti krijues mbi përbindëshat e kaosit primitiv.

Në mesopotami krijimi i gjithësisë edhe gjithçkaje që ka brenda u krye vetëm pas fitores së perëndisë Marduk mbi hyjninë e gjinis femër Tiamat; në mitet kananease perëndia Aleyan Baal, lufton me një farë perëndie të quajtur Mot, me një tjetër të quajtur Det (Rahab), dhe me një të tretë të quajtur Leviathan.

Sidomos ky i fundit, i cili sipas legjendës ishte një përbindësh në formë gjarpri apo në formën e një Kuçedre deti me shtatë kokë, përmendet shpesh si në librin e Jobit ashtu edhe në libra të tjerë të Dhjatës së Vjetër.

Njësoj si në mitologjitë e Orientit edhe në këtë libër këto figura legjendare konsiderohen si krijesa të vërteta dhe aspak imagjinare. Njësoj si në legjendat e hershme këto krijesa shihen si kundërshtarë të Zotit krijues dhe përfaqësues të fuqive të kaosit dhe të çregullimit. Autori i panjohur i librit të Jobit, nuk ka denjuar as ti ndryshoj emrat këtyre përbindëshave legjendar por i ka emërtuar në librin e tij me të njëjtin emër që ato mbanin në përrallat mitologjike.

Le të shohim, se çfarë thuhet në librin e Jobit në lidhje me këto krijesa imagjinare.

Tek Jobi 3:8 lexojmë: *“E mallkofshin ata që mallkojnë ditën, ata që janë gati të zgjojnë Leviathanin”*

Në një nga përkthimet e Biblës në gjuhën italiane, e cila është fryt i mëse 90 specialistëve, ky verset komentohet kështu: *“Leviathan: përbindësh imagjinari i përshkruar si një përbindësh apo një kuçedër; konsiderohet krijesë e Perëndisë (shih Jobin 40:25; 41:4), por edhe armik i tij (shih Isaia 27:1). Këtij i atribuohet fuqia për të kullufitur yjet dhe për të shkaktuar eklipset”* [8].

Dom Simon Filipaj, tek ky verset jep këtë koment: *“Lugatin- Leviathanin: përbindësh i kaosit që përpin diellin; e quajta lugat këtu, sikurse bestytëritë popullore: Lugati përpi hënën”* [9]. Ndërsa tek *“La Sacra Bibbia”* Edizioni Paoline, Romë 1968, f. 626 lidhur me këtë verset gjejmë këtë koment: *“Ata që mallkojnë ditën: janë magjistarët; besohej se ata ashin të aftë, falë magjive të tyre, të ndryshonin ditët e lavdishme në ditë ogurzeza dhe të shkaktinin eklipse në të cilat Leviathani kullufiste në mënyrë të menjëhershme diellin. Leviathan, tek 40:25 nënkupton krokodilin ndërsa tek Psalmi 103:36 tregon një cetacë të madh ujor. Mirëpo këtu është përdorur sipas kuptimit të tij etimologjik, ashtu siç njihet edhe në tekste të lashtë fenikase, si gjarpër dredharak, gjarpërues, i fuqishmi me shtatë kokë: përbindësh i kaosit primitiv, të cilin imagjinata popullore besonte se mund të thirrej me anë të magjisë (shih Psalmi 104 [103]: 26; Isaia 27:1)”*.

Tek Jobi 7:12 në lidhje me perëndinë e detit lexojmë: *“A jam vallë deti apo një përbindësh i detit që ti më ruan me një roje”*.

Në një përkthim biblik ky verset komentohet kështu: *“Roje, përbindësh i detit: bëhet fjalë për rrëfime të lashta mbi krijimin, në të cilat deti dhe përbindëshi i detit përfaqësojnë fuqi të liga të cilat i kundërvihen veprës së perëndisë krijues”* [10]

Tek Jobi 9:13 lexojmë: *“Perëndia nuk e tërheq zemërimin e tij; poshtë tij përkulen ndihmësit e Rahabit”*

Një përkthim i njohur biblik jep këtë koment: *“Rahab është një përbindësh i kaosit primitiv: që përfaqëson detin”* [11].

Në një tjetër përkthim të njohur biblik gjejmë këtë koment: *“Rahab, dhunë, arrogancë, në disa vënde në Bibël nënkupton Egjiptin, këtu shfaqet si personifikimi i një tjetër përbindëshi të ngjashëm me Leviathanin (shih Jobi 26:12 dhe Psalmi 88:11)...”* [12].

Në një fjalor të njohur biblik pohohet: *“R?habh, ‘Stuhi’, ‘arroganc’ (Jobi 26:12; 9:13, ‘krenar’ A.V.; Isaia 30:7, ‘i fuqishëm’ A.V.). Një emër i veçantë i përdorur në kuptim të fjalëpërfjalshëm dhe në kuptim figurativ. Në kuptim të fjalëpërfjalshëm ai tregon një përbindësh detar mitologjik i të njëjtin lloj siç është edhe Kuçedra (q.v.), me shumë mundësi ka lidhje me mitin semit të Tiâmatit, shkatërruesja e rendit të*

Zotit në univers (Jobi 26:12; Isaia 51:9). Në kuptimi figurativ është një emër i dhënë Egjiptit (Psalmet 87:4; 89:10; Isaia 30:7 R.V.)...” [13].

Tek Jobi 26:13 lexojmë: “Me Frymën e tij ka zbukuruar qiejt, dora e tij ka shpuar tejpertej gjarpërin dredharak”

Dom Simon Filipaj fjalën Gjarpëri dredharak e ka përkthyer Shlligë fluturuese dhe mbi këtë verset jep këtë koment: “Shlligë fluturuesen – personifikim i fuqive natyrore që e turbullonin kthjelltësinë e qiellit: Lugati ndër ne që e zinte hënën/bestytni popullore” [14].

Siç shihet nga ky parashtrim i shkurtër, në librin e Jobit mitologjitë e Orientit dhe figurat legjendare që gjenden në to, konsiderohen si krijesa të Zotit dhe konceptet dualiste në lidhje me krijimin që përmbajnë këto rrëfime (lufta midis kaosit primitiv dhe perëndisë krijues) besohen si të vërteta.

Shumë studiues të krishterë kanë tentuar të argumentojnë se këto figura janë përdorur në mënyrë figurative. Kjo tezë e tyre siç e pamë më lartë është e pabazuar [15]. Është e vërtetë që në disa raste këto figura legjendare janë përdorur në mënyrë simbolike. (p.sh. për të simbolizuar Egjiptin), por është dhe aq e vërtetë që në shumë pjesë të tjera këto përbindësia legjendar konsiderohen si krijesa reale dhe jo imagjinare. Këtë fakt, përveç apologjetëve fanatikë, e kanë pranuar pjesa dërrmuese e teologëve të krishterë, disa shembuj ne i dhamë më lart.

Për më shumë, libri i Jobit nuk shfaqet problematik vetëm në lidhje me këtë çështje.

Për shembull, hebrenjtë besonin se malet në horizont shëbenin si shtylla për qiellin të cilat bënë të mundur në këtë mënyrë që qielli i konceptuar si një kupolë metalike të mos binte në tokë.

Libri i Jobit këtë koncept antishkencor e konsideron të vërtetë dhe në kapitullin 26 verseti 11 lexojmë: “Kollonat e qiellit dridhen dhe habiten nga kërcënimi i tij”

Në një përkthim të Biblës gjejmë këtë koment: “Kollona: sipas hebrenjve të lashtë, malet në horizont ishin kollona të cilat mbanin qiellin” [16].

Sipas hebrenjve të lashtë toka mbahej nga disa shtylla gjigande. Tek libri i Jobit 9:6 lexojmë: “Ai e tund tokën nga vendi i saj dhe kollonat e saj dridhen”.

Po i njëjti përkthim biblik të cilin e përmendëm tek Jobi 26:11 e komenton kështu këtë verset: “Kollona: bëhet fjalë për një besim të lashtë sipas së cilit toka mbahet mbi shtylla” [17].

Po në librin e Jobit pohohet se vepra e parë që ka krijuar Zoti është hipopotami (Behemot, shih Jobi 40: 15-19).

Duke pasur parasysh këto që sapo thamë nuk ka pse të na çudisë fakti që mitologjitë e Orientit apo figura të përbindësive legjendar të përmenden dhe të konsiderohen të vërteta në librin e Jobit.

Si përfundim duhet të themi që ndaj vërejtjeve të tilla nuk duhet dhe nuk mundet, siç ndodh shpesh, të mbahen qëndrime indiferente, duke i kaluar nën heshtje apo duke i trajtuar me eufemizëm të kotë më qëllim që të minimizohet graviteti i këtyre fakteve.

## Referenca

- [1] “La Sacra Bibbia”, Edizioni Paoline, Romë 1968, f. 623). Dom Simon Filipaj shprehet, gjithashtu, se “Autori mbetet i panjohur” (“Bibla”- Përkthim dhe shtjellim nga Dom Simon Filipaj, vep. e cit., f. 623).
- [2] “New Bible Dictionary”- Second Edition- Edited by J. D. Douglas, F. F. Bruce, J. I. Packer, N. Hillyer D. Guthrie, A. R. Millard, D. J. Wiseman, shtëpia botuese Intervarsity Press, Downers Grove Illinois 1982, f. 598. Të shihet edhe “Bibla”- Fjala e Zotit për njeriun e çdo kohe, shtëpia botuese “Ave”, 1995, f. 33; si dhe “La Sacra Bibbia”- a cura della Conferenza Episcopale Italiana, vep. e cit, f. 505).
- [3] “Introduction to the Old Testament”, filluar nga Ernst Sellin, plotësuar, rishikuar dhe rishkruar nga Georg Fohrer, Abingdon-Nashville 1978, f. 350
- [4] “A New Standard Bible Dictionary”, edited by M. W. Jacobus, E.C. Lane dhe A.C. Zenos, Fung and Wagnalls Company, Nju Jork 1929, f. 457
- [5] Davide Levi, “L’antico Testamento”, vëll. i II i serisë “Per Capire la Bibbia”, botime “Ave”, Romë 1993, f. 38
- [6] “A New Standard Bible Dictionary, edited by M. W. Jacobus, E.C. Lane dhe A.C. Zenos, vep. e cit., f. 457. Për daljen në dritë të kësaj vepre kanë kontribuar mëse 59 specialistë të shquar në fushat biblike
- [7] Carlo Chidelli në “La pazienza di Giobbe”, vëll. 25 i serisë “Per Capire la Bibbia”, Romë 1993, f. 15
- [8] “La Bibbia”- Traduzione Interconfessionale in Lingua Corrente, Botime LDC-ABU, Torino 1986, f. 863
- [9] “Bibla”- Përkthim dhe Shtjellim nga Dom Simon Filipaj, vep. e cit., f. 625
- [10] “La Bibbia”- Traduzione Interconfessionale in Lingua Corrente, vep. e cit., f. 866
- [11] “La Sacra Bibbia”, a cura della Conferenza Episcopale Italiana, Romë 1986, f. 510
- [12] “La Sacra Bibbia” Edizioni Paoline, Romë 1968, f. 630
- [13] “A New Standard Bible Dictionary”, edited by M. W. Jacobus, E.C. Lane dhe A.C. Zenos, Fung and Wagnalls Company, Nju Jork 1936, f. 760
- [14] “Bibla”- Përkthim dhe Shtjellim nga Dom Simon Filipaj, vep. e cit., f. 643; shih edhe Psalmi 73[74]:13,14; 88[89]:10,11; 103[104]:26; Isaia 30:7; 5:19; Amos 9:3, etj
- [15] Le të shihet edhe “The Interpreter’s Dictionary of the Bible”, Edited by George Arthur Buttrick, Abingdon Press, Nashville, Nju Jork, 1962, f. 706
- [16] La Bibbia”- Traduzione Interconfessionale in Lingua Corrente, vep. e cit., f. 882
- [17] La Bibbia”- Traduzione Interconfessionale in Lingua Corrente, vep. e cit., f. 868

## Date Created

14/01/2013

## Author

erasmusi